

A K T T H E M E L I M I

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“HORIZON TRAVEL” SHPK

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

Z.Orgest HABILAJ, lindur ne VLORE, me 23.03.1989, banues ne Tirane, shtetas shqiptar, identifikuar me Leternjoftimin elektronik me numer I90323085H, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Z.Fatlind BARDHI lindur ne Bajram Curri, me 26.01.1988, banues ne Tirane, shtetas shqiptar, identifikuar me Leternjoftimin elektronik me numer I80126033K, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Mbeshtetur ne Ligjin nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe Ligjin Nr.9723 date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" dhe ne Legjislacionin shqiptar ne pergjithesi, personat e mesiperm jane Ortaket e shoqerise si me poshte:

Emertimi, Selia dhe afati i Shoqerise

Neni 1

Shoqeria eshte person juridik Shqiptar, veprimtaria e se ciles rregullohet nga kjo kontrate, Statuti i saj dhe Legjislacioni ne fuqi.

Neni 2

Shoqeria eshte emertuar “**HORIZON TRAVEL**” SHPK.

Neni 3

Shoqeria ka Seline e saj ne : Rr. “Elbasanit”, Pall. 10/1, njesia administrative nr.2, Tirane, Shqiperi.

Neni 4

Shoqeria do te zhvilloj aktivitetin e saj me afat te pakufizuar. Ky afat mund te shkurtohet me vendim te Ortakeve te shoqerise.

Shoqeria “**HORIZON TRAVEL**” SHPK gezon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti regjistrimit si e tille ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 5

Shoqeria “**HORIZON TRAVEL**” SHPK zhvillon aktivitetin e saj si me poshte :

Objekti i veprimtarise se Shoqerise dote jete si me poshte. Ushtrim i veprimtarise se lire private ne fushen e turizmit ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Organizim i grupeve te ndryshme turistike vendas dhe te huaj dhe kryerja e guidave turistike me ta. Akomodimi i grupeve te ndryshme turistike ne hotele, fshatra turistike, kampingje, shtepi pushimi, restorante, etj. Shoqerim me perkthyes dhe cicerone i grupeve te ndryshme turistike ne guidat e tyre brenda dhe jashte vendit. Agjensi per shitjen e biletave te udhetimit per mjetet e transportit ajror, detar, hekurudhor dhe tokesor sipas marreveshjeve te bera me persona te ndryshem fizike dhe juridike vendas dhe te huaj ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Organizim dhe kryerje e sherbimit te ndermjetesimit, te perfaqesimit dhe te komisionerise me persona fizike dhe juridike vendas dhe te huaj per kryerjen e veprimtarive te ndryshme turistike. Organizimi dhe kryerja e propagandas dhe reklames turistike me mjetet e ndryshme te informacionit te lejuar. Organizim dhe kryerje e veprimtarive te ndryshme me turistike vendas dhe te huaj, si: hipizem, moto ciklizem, gara makinash, bicikletash, etj. Sherbim parkimi dhe dhenie makinash me qera. Shoqeria gjithashtu mund te bashkepusoje me shoqeri te tjera me objekt te njejte ose te ndryshem te saj.

Me vendim te argumentuar te ortakeve te shoqeris, shoqeria mund te shtoje apo pakesoje objektin e veprimtarise te saj.

Neni 6

Shoqeria ushtron aktivitetin e saj ne Shqiperi dhe/ose jashte saj.

Neni 7

Selia e shoqerise mund te transferohet.

Neni 8

Kur shoqeria pushon veprimtarine e saj, pasi shlyen te gjitha detyrimet qe ka, pjesen e mbetur te kapitalit dhe te te ardhurave e perfitojne Ortaket e Shoqerise.

Ortaket themelues perballojne humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres se tyre te derdhur ne formimin e kapitalit themeltar. Kapitali baze mund te rritet nga fitimi, ne natyre, ose kredi ne leke ose valute qe merret ne Banke si dhe me kapitale te derdhura nga vete ortaket.

Kapitali i Shoqerise eshte ne shumen 10,000 (dhjete mije) Lek, e perbere nga Ortaket Themelues, Z. Orgest Habilaj 1 (nje) kuote me vlere 5,000 (pese mje) Lek dhe Z. Fatlind Bardhi, 1 (nje) kuote me vlere 5,000 (pese mije) Lek.

Fitimet qe do te rezultojne pas miratimit te bilancit vjetor nga Ortaket pas zbritjes se taksave do te ndahen si vijon:

- Fondi rezerve.
- Shperblimi qe i takon Ortakeve themelues.

Neni 9

Shoqeria mund te hyje ne veprimtari te perbashketa me shoqeri te tjera shqiptare ose te huaja edhe kur ato nuk kane objekt aktiviteti ate te shoqerise.

Neni 10

Veprimtaria e shoqerise mund te ushtrohet duke krijuar filiale ose perfaqesi brenda dhe jashte vendit, ne konformitet me ligjin shqiptar ose te huaj.

Administrimi

Organi vendimor i shoqerise eshte asambleja e ortakeve.

Neni 11

ADMINISTRATORI / ADMINISTRATORET

Ne shoqerine "HORIZON TRAVEL" SHPK administrator i shoqerise do te jete: Z. Orgest Habilaj, lindur ne Vlore, me 23.03.1989, banues ne Tirane, shtetas shqiptar, identifikuar me Leternjoftimin elektronik me numer I90323085H, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Administratori emerohet per nje kohezgjatje prej pese vjetesh financiare. Administratori ka te gjitha kompetence per te kryer te gjitha veprimet me interes te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e veprimtarise se shoqerise me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji nuk i njeh. Administratori ndryshohet me vendim te asambles se Ortakeve.

Mbyllja e Shoqerise:

Neni 12

Veprimtaria e shoqerise pushon me propozimin e bere nga asambleja e Ortakeve vetem, kur gjate dy vjeteve nuk rezulton rentabel si dhe ne te gjitha rastet qe parashikohen ne dokumentet e krijimit te shoqerise. Shoqeria shperndahet ne forme riorganizimi ose likujdimi.

Kur shoqeria likujdohet:

Neni 13

Ortaket emerojne likujdatorin dhe shoqeria i jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te ketij bilanci te likujdimit. Komisioni i Likujdimit perbehet nga nje ose tre antare. Pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, shiten ne vartesi te shkalles se konsumit te tyre. Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise e te fililave te saj dhe fondet financiare i kalojne Ortakeve, pasi te jene bere pagesat per kreditoret.

Neni 14

Kur pushon veprimtaria e nje filiali, per efekte te riorganizimit te tij, afatet e pushimit caktohen nga Ortaket. Likujdimi i filialeve behet njelloj si per shoqerine.

Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se filialit te likujduar dhe fondet e tij financiare vihen ne dispozicion te shoqerise pasi tu jene bere pagesat likujdatoreve.

Dispozita te hollesishme mbi organizimin e kesaj shoqerie percaktohen ne statutin e saj.

Date 28/07/2022

HORIZON TRAVEL SHPK

ORTAKET THEMELUES

Fatlim Bardhi

Fatlim Bardhi



Orgest Habila

Orgest Habila

